

Kerkese per informacion nga Hashtag.al

From: habjonhasani@proton.me

habjonhasani@proton.me



To: Info@azht.gov.al

Info@azht.gov.al



fserjani@gmail.com

fserjani@gmail.com



Date: On Mon, Dec 23, 2024 at 15:31

 3 attachments(2,4 MB)



Te nderuar perfaqesues te Agjencise se Territorit (AZHT). Ne vijim te komunikimit verbal me kolegun tuaj Florion Serjani, po ju rendis disa pyetje te cilat kane per qellim nje raportim sa me te ekuilibruar dhe te paanshem nga Hashtag.al.

Pyetjet e renditura ne vijim:

1. Ne vendimin e konceptuar dhe te shpallur nga institucioni juaj, vendimi nr.11 date 29.05.2024, shpallet revokimi dhe shfuqizimi i lejeve te zhvillimit te disa prej projekteve infrastrukturore me te medha te vendit. Ne dokument, titullarja, zonja Adelajda Rroka rezulton se ka firmosur kete vendim me daten 28 Tetor.

Si ndodhi qe nje vendim i firmosur me daten 28 Tetor 2024, rezulton i shpallur qe prej 29 Majit 2024?

2. Bazuar ne legjislacionin shqiptar, shfuqizimi i lejeve te zhvillimit a i ben NUL dhe lejet e ndertimit; derisa keto te fundit mund te bazohen vetem ne konturet qe percakton leja e zhvillimit?

3. Ne projektet qe ju keni listuar si "Lista 1" ne vendimin ne 11. date 29.05.2025, ku i referoheni lejeve te zhvillimit dhe projekteve perkatese nga krahasimi qe kemi bere, numrat e vendimeve nuk perputhen, jo ne nje apo ne dy raste, por ne te gjitha subjektet e listes nuk perputhet numri i vendimit me objektin.

Si shembull, ju referoni ne "Lista 1", vendimin per lejen zhvillimore nr.6 date 17.05.2019 per Aeroportin e Kukesit. Por ne vendimet e shpallura ne faqen tuaj zyrtare elektronike, vendimi nr.6 date 17.05.2019 korrespondon me miratimin e nje plani per menaxhimin e mbetjeve te ngurta (bashkelidhur shtojca 1).

Ose nje shembull tjeter: ju referoni ne "Lista 1", vendimin per lejen zhvillimore nr.27 date 28.12.2020 per "Ndertimin e portit dhe marines se Limionit ne Sarande", por ne faqen tuaj zyrtare rezulton se nr.27 date 28.12.2020 korrespondon me nje leje ndertiminte lidhur me procesin e galvanizimit te metalurgjikut ne Elbasan (shtojca 2).

Keto mosperputhje jane absolute per te gjitha pikat e "Lista 1" te vendimit tuaj nr.11 date 29.05.2024, ne keto kushte vlen te pyesim:

-Si ka mundesi qe lejet e zhvillimit te subjekteve ne "Lista 1" korrespondojne me te tjera vendime te firmosura nga institucioni juaj?

-A ekzistojne keto leje zhvillimi? Nese po, cilat jane numrat e vendimeve te tyre?

Duke mirepritur qendrimin dhe shpjegimet tuaja profesionale ju urojme pune te mbare.

Sent from [Proton Mail](#) for iOS